



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 18.12.2023

Nr: 194

Ora: 11:30

VENDIM

PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 96, DATË 04.12.2023, TË DEPOZITUAR NGA ORGANIZATA QENDRA "QËNDRESA QYTETARE"

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 18.12.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvin	LAKO	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Organizata Qendra "Qëndresa Qytetare"

OBJEKT: Kundërshtim i vendimit nr. 811, datë 20.10.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

BAZË LIGJORE: Nenet 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Organizata Qendra "Qëndresa Qytetare" ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 96 regj., datë 4.12.2023.

Në seancën e datës 18.12.2023, KAS konstatoi se kjo kërkesë ankimore nuk i plotëson elementët e verifikimit paraprak të parashikuara në nenin 130, pika "c" të Kodit Zgjedhor, për shkak se është depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përtej afatit 30 ditor të parashikuar në dispozitivin e vendimit të KSHZ. Sipas përcaktimeve të pikës 5, të dispozitivit të vendimit nr. 811, datë 20.10.2023, *"Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksionve brenda 30 (tridhjetë), ditëve nga shpallja e tij"*, pra afati për përfundimin e këtij ankimi ishte data 20.11.2023. Ankimi nga Organizata "Qendra "Qëndresa Qytetare", është administruar nëpërmjet shkresës nr. 7762 prot., datë 04.12.2023, përtej afatit të së drejtës për të ushtruar ankim.

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja "b", të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, "Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve" dhe nenit 130, shkronja "c" të Kodit Zgjedhor, duke qenë se nuk plotësohet elementi i respektimit të afatit ligjor për ankimim e për rrjedhojë nuk përmbushen në mënyrë kumulative të tre kushtet e parashikuara në nenin 130 të K.Zgjedhor, kërkesa ankimore regjistruar me nr. 96, datë 4.12.2023, nuk duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja "b" të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 96, datë 4.12.2023, të paraqitur nga Organizata Qendra "Qëndresa Qytetare".

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi, bazuar në pikën 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

U shpall sot, më datë 18.12.2023.

Elvin	LAKO	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar